



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

01-020/150022022/më
117
07. 02. 2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 17/2015 dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, sipas detyrës zyrtare, nxjerr këtë

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E RAPORTEVE TË LEJEVE
MJEDISORE KOMUNALE

I

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, për formimin e komisionit profesional për vlerësimin e raporteve të lejeve mjedisore komunale.

II

Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Zana Ismaili, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, kryesuese;
2. Dukagjin Gashi, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar dhe
3. Seniha Bajraktari, përfaqësuese nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtare.

III

Detyra e komisionit është që, në afatin prej 30 ditëve nga dita e pranimit të raportit, të japë mendimin për miratimin ose refuzimin e dhënies së lejeve mjedisore komunale.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Drejtoria e Inspeksionit.

V

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushojnë së vlejtori vendimet e mëhershme lidhur me formimin e komisionit për vlerësimin e raporteve të lejeve mjedisore.

VI

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm,
- Drejtorisë së Inspeksionit,
- Qendrës për shërbim me qytetarë dhe
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS

Shpend Ahmeti

07. 02. 2017

Shpend Ahmeti